



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 21/2015

Prishtinë, më 02.06.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Sala Berisha-Shala, Raif Qela, Blerim Grainca, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje- anëtarë.

Mungoi: Fatmir Rexhepi – anëtar.

Pjesëmarrëse e ftuar: znj. Hykmete Bajrami, ministre për Tregti dhe Industri.

Pjesëmarrës të tjerë: Rexhep Bllaca dhe Bashkim Navakazi – MTI; Lejla Selimi - OSBE; Zanë Hoxha - INDEP; Valmire Hoti - INFODIREKT.TV; Adelinë Sahiti - KOSOVAPRESS; Kaltrina Ahmeti – GLPS; Florina Merovci – ZPRK; Sylejman Blaku – KOSOVA SOT; Albulena Mavraj – EPOKA E RE; Besa Berisha dhe Arta Xhyllani –UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.05.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 05/L-040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L- 026 për Markat Tregtare;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur 26.05.2015

Procesverbal i mbledhjes së mbajtur më 26.05.2015 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit Nr. 05/L-040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L- 026 për Markat Tregtare

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa- Tha se për këtë pikë të rendit të ditës është e ftuar znj. Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe propozoi që së pari të paraqesë arsyetimin e Projektligjit Nr. 05/L-040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L- 026 për Markat Tregtare dhe pastaj të hapim debatin.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë - Tha se shkurtimisht po e paraqes arsyen, qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen arsyet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-026 për Marka Tregtare. Ajo theksoi se arsyeshmëria për propozimin e ndryshimit të Ligjit për Markat Tregtare është në harmonizimin e mëtejme të këtij ligji me legjislacionin e Bashkimit Evropian që rregullon procedurat e ekzaminimit të Markave Tregtare dhe dispozitat që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji. Ligji për Marka Tregtare në fuqi, sipas ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë të angazhuar përmes projektit të BE-së, kanë theksuar që ka disa mangësi të cilat nuk janë eliminuar me miratimin e ligjit në vitin 2011. Prandaj, duke u bazuar në rregulloren e BE-së për Markat Tregtare dhe në Direktivën për fushën e zbatimit të të drejtave pronësore intelektuale është e domosdoshme që të procedohet me ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji. Znj. Bajrami, tha se ndryshimet dhe plotësimet e propozuar kanë të bëjnë me procedurat e ekzaminimit të Markave Tregtare, çështjen e licencimit dhe autorizimit të përdorimit të markës tregtare, plotësimi i arsytimit për shfuqizimin e një marke të regjistruar tregtare, si dhe dispozitat që kanë të bëjnë me procedurat paraprake dhe masat e përkohshme që iu lejohen pronarëve të markave tregtare konform dispozitave ndëshkuese në rastet e keqpërdorimit apo shkeljes së të drejtave që rrjedhin nga ligjet në fuqi. Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-026 për Marka Tregtare, ndërlidhet edhe me objektivat e Qeverisë, respektivisht të MTI-së. Me ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji sigurohet një mbrojtje më e mirë juridike për subjektet juridike të cilët kërkojnë mbrojtje të aseteve të kompanive të tyre. Si rezultat i kësaj, miratimi i këtij ligji siguron një ambient akoma më të përshtatshëm për mbrojtjen e pronësisë industriale në Kosovë, që rrjedhimisht ndikon edhe në promovimin e investimeve të huaja. Në fund, tha dua të ju siguroj që propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për marka tregtare është hartuar në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane dhe theksoj që miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të këtij ligji është kusht që Kosova duhet plotësuar me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në. Në këtë marrëveshje në mënyrë specifike theksohet që Kosova obligohet që të ofrojë mbrojtje të njëjtë në fushën e pronësisë intelektuale, duke përfshirë edhe markat tregtare, me ato të vendeve të Bashkimit Evropian. Prandaj, procedimi i këtij ligji është i rëndësishëm dhe ju propozojmë që ta shqyrtoni dhe miratoni këtë Projektligj në këtë mbledhje të Komisionit.

Kryetari - Tha se Ligji për Markat Tregtare është një ligj që përmban disa kushte për mbrojtjen e markës tregtare. Esenciale është që bënë mbrojtjen e konsumatorëve, prandaj është për të mirëpritur që krijon kushte për mbrojtjen e markës. Ai theksoi që duhet ta ngrehim vetëdijen tonë po ashtu edhe të bizneset, qoftë vendore, apo qoftë investitorët e huaj, që të bindën se ka ligj që e

mbrojnë markën tregtare dhe investimi i tyre është i mbrojtur. Prandaj është me rëndësi të aprovohet ky ligj, pasi që po e rregullon një fushë dhe mundësi më të lehtë e të bërit biznes.

Raif Qela – Tha se ligji për Markat Tregtare rregullon një fushë të rëndësishme të jetës sonë, dhe plotësim - ndryshimi i këtij ligji do ta rregullojë më mirë këtë fushë. Në projektligj në nenin për qëllimin e projektligjit janë vendosur edhe Direktivat me të cilat është në përputhshmëri ky projektligj, konstatoi z. Qela. Në bazë të asaj që kam parë në ligjet e vendeve tjera në qëllimin e ligjit nuk përmenden Direktivat, por zakonisht, ose janë në formë të aneksit ose në dokument tjetër që e përcjell projektligjin. Lidhur me këtë z. Qela shprehu mendimin se në qëllimin e projektligjit nuk duhet të futen Direktivat, sepse nuk është qëllimi i ligjit përputhja me Direktivat, por të rregullon çështjen përkatëse.

Rexhep Bllaca (drejtor i Departamentit Ligjor – MTI) – Tha edhe pse pajtohem me deputetin Qela, sqaroi se me Udhëzimin Administrativ për Standardet e Hartimit të akteve normative në qëllimin e projektligjit duhet të vendosen aktet e legjislacionit të BE-së me të cilat përputhet projektligji. Z. Bllaca shtoi se ka praktika të ndryshme të hartimit të legjislacionit në vende të ndryshme.

Sala Berisha-Shala – Potençoi se qëllimi i projektligjit si duket është me shndërruar Zyrën në Agjenci, një situatë “de facto”, por duan me kthye në “de jure”. Ajo shtoi se validiteti i markave tregtare nuk varet se a është Zyrë apo Agjenci. Kontributin tim, tha ajo për projektligjin do ta japë në fazën e amendamentimit. Deputetja Berisha-Shala potençoi se kjo ministri është e ngarkuar me Agjencitë.

Kryetari – Tha se në fazën e amendamentimit do të shohim se cila është mënyra më e mirë dhe me amendament ta rregullojmë, në mënyrë që ky institucion të jetë sa më funksional.

Visar Ymeri – Tha se projektligji për plotësimin e ligjit për patenta dhe për markat tregtare janë pjesë të pakos së ligjeve të pronësisë industriale dhe duhet që të dërgohen në të njëjtën kohë për shqyrtim në parim në seancë plenare. Përputhshmëria me legjislacionin e BE-së keni thënë se është arsyeja kryesore e plotësim- ndryshimit të ligjit, iu drejtua përfaqësuesve të ministrisë deputeti Ymeri. Ai lidhur me këtë pyeti se cilat janë ato fusha të veçanta problematike të cilat nuk kanë qenë të përputhura me ligjin në fuqi? A keni vërejte probleme në zbatim të ligjit? A keni statistika për mbrojtjen e markave tregtare? A po rregullohet një fushë që i takon tregtisë apo prodhimit?

Pal Lekaj – Tha se pajtohem me z. Ymeri që ligjet të ndryshohen atëherë kur kanë probleme në zbatim. Ai pyeti se cilat janë sfidat e zbatimit të ligjit? Cilat pika janë të pazbatueshme që duhet të ndryshohen? Ai shtoi se në projektligjin për plotësim ndryshimin e ligjit për markat tregtare nuk kam parë ndonjë ndryshim thelbësor. Z. Lekaj potençoi se nëse me këtë projektligj është qëllimi për të mbuluar atë që ka ndodhur në ministri atëherë kjo është shqetësuese.

Rexhep Bllaca (drejtor i Departamentit Ligjor – MTI) – Sqaroi se në Raportin e Progresit thuhet se projektligji është pjesërisht i përputhshëm me legjislacionin e BE-së, dhe shtoi se edhe kjo është prej arsyeve të plotësim ndryshimit të ligjit. Fushat në të cilat bëhet plotësim ndryshimi janë të natyrës procedurale, afatet, rregullim më të mirë të dispozitave sepse kur janë përkthyer direktivat janë përcjellë me gabime dhe me plotësim- ndryshim evitohen gabimet.

Ministrja Hykmete Bajrami – Sqaroi se regjistrimi i markave tregtare është i rëndësishëm edhe për tregtinë edhe për prodhimin. Ajo po ashtu sqaroi se në bazë të reformës në administratën publike me rregulloren për riorganizimin janë bërë ndryshimet në organizimin e ministrisë.

Ministrja njoftoi se kemi një opinion ligjor që Zyra duhet të jetë Agjenci, megjithatë nëse Komisioni mendon të bëhet ndonjë mënyrë tjetër e organizimit atëherë ne duhet ta pranojmë.

Besim Beqaj – Duke iu referuar drejtorit të departamentit ligjor të MTI-së tha se Raporti i Progresit duhet të lexohet më gjerësisht e t'i shohim me kujdes rekomandimet e raportit. Ai theksoi se mos t'i personalizojmë gjërat, duhet të shohim argumentet, të bëjmë zgjedhjen e duhur dhe të bëjmë një ligj më funksional

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa - Në fund tha se ne do të analizojmë gjatë shqyrtimit me grupin punues dhe në lexim të dytë mirë dhe në detaje projektligjin se çka duhet të plotësohet të ndryshohet gjatë amendamentimit dhe do të shohim argumentet se çka është më funksionale, se çka është në interes të mbrojtjes së markave tregtare. Ai theksoi që duhet të nxjerrim mësim për gjitha propozimet që do t'i diskutojmë dhe duhet t'i argumentojmë mbi bazën e harmonizimit të ligjeve. Propozoi që Projektligji për Patenta dhe Projektligji për Marka Tregtare të shkojnë në shqyrtim në pako në parim në seancë plenare, po ashtu të jenë edhe në lexim dytë në pakon në Komision. Ai tha se ne, si Komision, problemin më të madh e kemi me agjencinë e pavarur që janë në kuadër të Kuvendit, ndërsa për ato agjenci që janë brenda ministrive janë çështjeje të brendshme të ministrive përkatëse se si i rregullojnë.

Pas debatit, Komisioni vendosi me 6 (gjashtë) për dhe 4 (katër) abstenime, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim projektligji Nr. 05/L-040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L- 026 për Markat Tregtare

2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji pas miratimit të parim nga Kuvendi do të jetë në këtë përbërje: Muhamet Mustafa, kryesues, Visar Ymeri dhe Sasha Milosavljeviq, anëtarë.

4. Të ndryshme

Projektligji për Dixhitalizimin e transmetimeve radio -difuzive tokësore

Raif Qela- Tha duke pasur parasysh rëndësinë tepër të madhe që ka ky ligj për rregullimin e fushës në fjalë, hapat të cilat duhet që t'i ndërmarrë ky Komision, mendoj se nuk duhet të jenë të nxituara, nëse kemi qenë të vonuar për vite të tëra mbase edhe një dekadë. Ky Komision mendoj se duhet të bëjë hapa shumë të kujdesshëm në mënyrë që kur të dalë ligji, të dalë si funksional, e jo të ketë pasoja siç ka pasur. Mos rregullimi si duhet i kësaj fushe në krejt rajonin, të gjitha shtetet për rreth kanë probleme me ligjin për dixhitalizimin e transmetimeve radio -difuzive tokësore, prandaj është mirë që ne, si Komision, të analizojmë mirë secilin hap që e bëjmë. Ai theksoi se deri tani punën që ka bërë bashkë me personelin Komisionit ka qenë përpjekje që ta sigurojmë një punëtori, të cilën nuk e di a do të mundemi që ta sigurojmë. Kam analizuar të tre të propozuarit për ekspertë, të cilët prapë unë po e përsëris nuk konsideroi që janë ekspert të fushës, vetëm njëri prej tyre që ka punuar ARKEP një periudhë të caktuar edhe nuk e ka pasur fushën adekuate në ARKEP, ndërsa 6 (gjashtë) muaj të tjerë ka qenë në një kurs për transmetimet radio-difuzive, ndoshta ajo është deri diku fushë përkatëse. Kam hulumtuar bukur shumë për ekspert të mundshëm, këtu i kam 6 (gjashtë) emra prej të cilëve asnjëri, nuk mund t'i marrim vetëm sa për të ia dhënë një page në muaj. Së pari kam biseduar, siç ju thashë edhe herën e kaluar, me Ismet Hamitin, i cili ka punuar mbi 20 vjet në ITU, megjithëse e ka një përgatitje në përgjithësi

konsideron se nuk është ekspert i kësaj fushë ngase është fushë shumë e veçantë, deri sa është kjo kështu shumë të tjerë kanë thënë se jemi ekspertë, megjithëse as përafërsisht nuk i afrohen nivelit të tij. Ndër të propozuarit prej meje janë Rexhep Hasani - shef i Departamentit të telekomunikimeve në fakultetin e inxhinierisë elektrike nuk jam i sigurt se a është ekspert i mirë dhe Bujar Krasniqi për të cilët mund të ua siguroj CV-të. Ndoshta në tri ditët e ardhshme së bashku me anëtarët e Komisionit edhe me Komisionin përkatës për Administratë Publike, Media etj, ose kah fundi i javës të mbajmë një takim edhe aty të vendosim se cilin prej ekspertëve ta caktojmë.

Komisioni i dha autorizim të plotë grupit të punës që ta caktoj ekspertin dhe sa më shpejt të procedoj më amendamentet për shkak të afatit dymujor për shqyrtim të projektligjit.

Nga vizita në Bruksel

Besim Beqaj- E njoftoi Komisionin për vizitën në Bruksel, e cila është realizuar më 6 maj 2015 ftuar nga Sekretariati i Energjisë më seli në Vjenë. Z. Beqaj, njoftoi së në këtë takim të Komitetit për Energji të Parlamentit Evropian, janë nxjerrë disa konkludime të bashkëpunimit ndërparlamentar, ku ideja që ka dalë nga ky takim është që të themelohet Asambleja Parlamentare e Komitetit për Energji të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Komisioni përkrahu propozimin nga Komiteti për Energji të Parlamentit Evropian dhe Sekretariati i Energjisë që edhe Kosova të jetë pjesë e Asamblesë Parlamentare për Energji të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Debati për Kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata

Kryetari i Komisionit- Tha që lidhur debatin për Kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata që e kemi pasur nga mbledhja e përbashkët me Komisionin për Legjislacion, kemi disa informata nga USAID apo një analizë dhe kërkoj që në të ardhmen e afërt do ta trajtojmë këtë çështje në Komision dhe do të dalim me rekomandime për Kuvend.

Komisioni kërkoj nga dy koordinatorët e dy komisioneve që të përgatisin një dokument në formë të rekomandimeve më të gjeturat e analizës dhe debatit dhe pastaj këto rekomandime të procedohen për shqyrtim në seancë plenare.

Informata e Kryesisë lidhur me NSH Amortizatorët

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa- Tha se edhe në mbledhjen e datës 19 maj 2015, ju kam informuar se kemi një *Përfundim* nga Kryesia e Kuvendit lidhur me një shkresë të Sindikatës të NSH Amortizatorët, lidhur me procesin e privatizimit, por këtë Kryesia e Kuvendit na ka dërguar vetëm si një njoftim dhe si Komision FunkSIONAL nuk si të merremi me këtë çështje dhe janë procedurat e Kuvendit se si duhet të ngritën debatet apo edhe Komisionet hetimore.

Stafi i Komisionit përsëri t'ua shpërndajë Informatën e Kryesisë anëtarëve të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Muhamet Mustafa